

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI I GJEOSHKENCAVE

MITROVICË



RAPORT VJETOR

Viti kalendarik 2019

Prof.Dr. Naser Peci, Dekan

Janar, 2020

Raport vjetor 2019

Përmbajtja

Përmbledhje	3
Vizioni dhe Misioni	3
Planet/aksionet e veprimit	4
Qëllimet, objektivat dhe prioritetet strategjike Fakultetit	5
Realizimi i Synimeve dhe Objektiveve	6
Procesi Akreditimit	6
Zgjedhjet në Fakultetin e Gjeoshkencave	7
Regjistrimi i studentëve për vitin akademik 2019/2020	7
Studenët e diplomuar për vitin 2019	7
Konkursi për staf akademik për vitin 2019	8
Aktivitetet shkencore e profesionale	8
Organizimi i Konferencës IMGK 2019	8
Bashkëpunimi në mes Fakulteteve, Institucioneve gjeoshkencore dhe Industrisë	9
Furnizimi me pajisje laboratorike	10
Procesi mbarëvajtjes së mësimit	11
Procesi realizimit provimeve	11
Mbledhjet e Këshillit Fakultetit	12
Shtojcat	
I – Planet mësimore sipas programeve të studimit për vitin akademik 2019/2020	13
II - Personeli mësimor i Fakultetit të Gjeoshkencave i angazhuar në procesin mësimor 2019-2020.	17
III – Marrëveshjet e Bashkëpunimit	18

Përmbledhje

Fakulteti i Gjeoshkencave ka përgatitur këtë Raport në përputhje me nenin 76 pika 7 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB) në Mitrovicë.

Ky raport ofron informacion mbi aktivitetet e Fakultetit Gjeoshkencave gjatë vitit kalendarik 2019. Viti 2019 është karakterizuar me funksionalizimin dhe vazhdimësinë e punës së Fakultetit të Gjeoshkencave në kuadër të UMIB, rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtarë sidomos me universitete nga vendet e Unionit Evropian.

Viti 2019 u karakterizua me faktin e mosakreditimit instuticional gjë që ka ndikuar edhe në disa aspekte të aktivitetit të Fakultetit sidomos sa i përket numrit të studentëve në pamundësi të regjistrimit të studentve të rinj në vitin e parë të studimeve në nivelin Bachelor dhe Master.

Sidoqoftë Fakulteti i Gjeoshkencave ka vazhduar në përmbushjen e obligimeve dhe konsideron që viti 2019 ishte një vit i suksesshëm për Fakultetin e Gjeoshkence që tregohet nga disa çështje si më poshtë:

- Fakulteti dhe stafi i fakultetit në mënyrë të kënaqshme kanë realizuar planin mësimor.
- Studentët patën mundësi për t'u ngritur profesionalisht përmes aktiviteteve tjera të angazhimit si janë vizitat profesionale në terren.
- Është punuar për rritjen e kushteve të zhvillimit të punëve kërkimore dhe aplikimi i projekteve në nivelin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Është vazhduar me furnizim me pajisje laboratorike për e funksionalizimin e Gjeolaboratorit
- Ka vazhduar bashkëpunimi dhe kontaktet me universitete dhe instutucione shkencore nga lëmia e gjeoshkencave në rajon dhe Evropë.
- Kanë vazhduar publikimet e stafit në revistat vendore dhe ndërkombëtare si dhe pjesëmarrja në konferenca e kongrese shkencore.

Vizioni dhe Misioni

Vizioni

Fakulteti i Gjeoshkencave është institucion i vetëm i arsimit të lartë në Kosovë që edukon ekspert kompetent dhe kryen kërkime shkencore e profesionale në fushën e gjeologjisë, xehetarisë dhe material&metalurgji. Me aktivitetet e tij Fakulteti vazhdimisht kontribon në zhvillimin dhe avansimin e profesionistëve ne fushën e gjeoshkencave.

Misioni i Fakultetit të Gjeoshkencave është sigurimi i edukimit cilësorë të studentëve universitar dhe pasuniversitar në lëminë e gjeoshkencave, tani dhe në të ardhmën, duke përmbushur sfidat në

furnizim me resurse natyrore, shfrytëzimin dhe përpunimin e tyre, zbutjen e rreziqeve natyrore, mbrojtjen e mjedisit dhe ndërgjegjësimin publik të fushën e gjeoshkencave.

Fakulteti i Gjeoshkencave është i angazhuar për të siguruar programe arsimore dhe kërkimore në dobi të studentëve, shkencës, shoqërisë dhe shtetit të Kosovës. Misioni i Fakultetit të Gjeoshkencave është i dhënë përmes synimeve në vazhdim:

- Zhvillimi i programeve arsimore kualitative për përgatitjen e studentëve për edukim dhe karrierë në shkencat e gjeologjisë, xehtarisë dhe metalurgjide materialeve.
- Ngritja e kuadrove profesionale në fushat e, gjeolgisë xehtarisë dhe metalurgjisë përmes zbatimit të metodave moderne të edukimit dhe hulumtimit.
- Zhvillimi i programeve kualitative që u sigurojnë studentëve MSc. dhe PhD aftësi të nevojshme për punë të pavarur kërkimore dhe mundësi punësimi në fusha të specializuara të gjeoshkencave.
- Zhvillimi dhe mirëmbajtja e programeve kërkimore që kontribuojnë në njohuri të reja të gjeoshkencave dhe ndihmojnë në një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Misioni

Fakulteti i Gjeoshkencave synon të siguroj nivelet më të larta të arsimit përmes rishikimit dhe zgjerimit të programeve arsimore, kërkimore, dhe informimit të vazhdueshëm, në mënyrë që të prodhojë gjeolog, xehtar dhe metalurg të trajnuar mirë, kompetent, akademikë dhe profesional, për t'iu përgjigjur nevojave të shoqërisë.

Programet studimit të Fakultetit të Gjeoshkencave do të sigurojnë kontribut të rëndësishëm me qëllim arritjen e të vepruarit të Fakultetit si partner barabart i Rajonit dhe Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe të Kërkimit, përmes:

- Edukimit mirëfillt për studentët e gjeoshkencave dhe për publikun në përgjithësi.
- Kërkimeve inovative dhe transformuese në lëminë e gjeoshkencave.
- Shërbimeve të shoqërisë përmes zgjerimit dhe përhapjes së njohurive gjeoshkencore.

Planet/aksionet e veprimit

Fakulteti i Gjeoshkencave në bashkëpunim me Zyrën për Zhvillim Akademik është duke realizuar një listë të aksioneve të veprimit që janë të lidhura direkt me rekomandimet e ekspertëve të akreditimit. Realizimi i aksioneve të veprimit do të përfshijë edhe përgjegjësitë e mësimdhënësve, departamenteve, dekanatit dhe universitetit për realizimin e rekomandimeve.

Fakulteti i Gjeoshkencave është duke vazhduar veprimtarinë bazuar në Planin Strategjik 2018 – 2021 me këto qëllime kryesore strategjike:

- 1: Ngritje akademike nëpërmjet programeve bashkëkohore "Të mësojmë duke bërë"
- 2: Përmirësimi i nivelit të studimeve
- 3: Promovimi i Fakultit Gjeoshkencave, Misionin dhe rëndësinë e tij në vend
- 4: Zhvillimi i marrëdhënieve të jashtme dhe mekanizmat përkrahës.
- 5: Angazhimi në mbledhjen e fondeve akademike dhe marketingun.

Në të ardhmën mbetet përpilimi i Planit Strategjik të Departamenteve, duke u bazuar në Planin Strategjik të Fakultetit.

Pas përpilimit të Planeve Strategjike planifikojmë formimin e Komitetit për zbatimin e planit strategjik të Fakultetit përkatësisht Departamenteve.

Qëllimet, objektivat dhe prioritetet strategjike Fakultetit

Qëllimet, objektivat dhe prioritetet strategjike Fakultetit në lëmitë e gjeoshkencave si janë gjeologjia, xehetaria dhe material&metalurgji janë organizimi i mësimit në nivelin Bachelor dhe Master si dhe synimi i organizimit të programeve të doktorates.

Në Fakultetin e Gjeoshkencave ekzistojnë tre departamente:

1. Departamenti i Gjeologjisë,
2. Departamenti i Xehetarisë,
3. Departamenti për Materiale dhe Metalurgji.

Studimet e nivelit Bachelor organizohen në këto programe sipas departamenteve:

Departamenti i Gjeologjisë

Programi: Gjeologjia e përgjithshme

Departamenti i Xehetarisë

Programi: Xehetaria (i përgjithshëm)

Departamenti për Materiale dhe Metalurgji

Programi: Materiale dhe Metalurgji (me specializime Materiale dhe specializimi Metalurgji)

Studimet e nivelit Master organizohen në këto programe sipas departamenteve:

Gjeologji

Programi: Hidrogjeologji me gjeologji inxhinierike

Programi: Vendburimet e lëndëve të para minerale

Xehetari

Programi: Xehetari

Metalurgji

Programi: Materiale

Programi: Metalurgji

Programet e studimit janë dhënë në shtojcën 1.

Realizimi i Synimeve dhe Objektivave

Realizimi i synimeve dhe objektivave arrihet përmes një mësimdhënie dhe udhëheqje efektive si dhe vlerësimin e mbështetjen e arritjes së qëllimeve/objektivave të mësimnxënies nga studentët. Mësimdhënia efektive është ndër faktorët më të rëndësishëm në nivel Fakulteti në përmirësimin e të mësuarit të studentëve kurse udhëheqja efektive është një komponent thelbësor i çdo shkolle të suksesshme.

Fakulteti i Gjeoshkencave posedon me staf akademik të mjaftueshëm dhe adekuat për realizimin e synimeve dhe objektivave (shtojca 2).

Arritja e qëllimeve dhe objektivave të mësimnxënies nga ana e studentëve bëhet përmes vlerësimit administrativ dhe sistemit mbështetës përmes mbledhjes së të dhënave, përpunimit të tyre. Në bazë të këtyre rezultateve pastaj përpilohen planet e përmirësimit për fakultetin.

Zyra për zhvillim akademik në kuadër të UMIB në fund të semestrit dimëror të vitit akademik 2019/2020 dhe ka filluar me shpërnadarjen e pyetësorëve për studentët. Koordinatorët ndoshta në bashkëpunim me një ekip të mësimdhënësve do të analizojnë të dhënat bazë për të përcaktuar nevojat më të rëndësishme për mësimnxënie nga studentët.

Procesi akreditimit

Në vitin 2019 kanë vazhduar aktivitetet për riakreditimin e programeve Xehetari përgjithshme – Bachelor, Xehetari dhe vendburimet e lëndëve të Para minerale – Master. Procesi ka përfunduar me sukses dhe këto programe janë riakredituar edhe për 3 vite.

Më poshtë janë programet e riakredituara dhe programet për të cilat është vazhduar akreditimi me kohëzgjatjen e tyre në Fakultetin Gjeoshkencave:

Për nivelin Bachelor

1. **Gjeologji** (i akredituar deri 30.09.2021)
2. **Xehetari** (i akredituar deri 30.09.2022)

3. **Materiale dhe Metalurgji** (i akredituar deri 30.09.2021)

Për nivelin Master:

1. **Vendburimet e lëndëve të para minerale** (i akredituar deri 30.09.2022)
2. **Hidrogjeologji me Gjeologji Inxhinierike** (i akredituar deri 30.09.2021)
3. **Xehetari** (i akredituar deri 30.09.2022)
4. **Materiale** (i akredituar deri 30.09.2021)
5. **Metalurgji** (i akredituar deri 30.09.2021)

Zgjedhjet në Fakultetin e Gjeoshkencave

Gjatë vitit 2019 janë realizuar zgjedhjet e rregullta sipas rregulloreve në fuqi të UMIB për studentët, Senatin, Këshillin e Fakultetit dhe Dekanin. Zgjedhjet kanë qenë të sukseshme dhe pa asnjë ankesë apo contest. Si rezultat I zgjedhjeve janë konsultuar Këshilli i Fakultetit, është zgjedhur një anëtar Senator nga radhët e FGJ si dhe është zgjedhur Denani i FGJ me mandat 4 vjeçar. Si rezultata u kësaj pastaj është formuar Komisioni i Studime në FGJ si dhe janë zgjedhur edhe Shefat e Depaetamenteve, Koordinatorin për zhvillim akademik, janë formuar Komisione të ndryshme në përputhje me Rregulloret në fuqi të UMIB. Paralamenti Strudentor ka deleguar përfaqësuesit e vet në Këshillin e Fakultetit, Komisionin e Studimeve si dhe komisione tjera ku është kërkuar përfaqësimi i studentëve.

Regjistrimi i studentëve për vitin akademik 2019/2020

Si rezultat i mosakreditimit instutucional për vitin akademik 2019/2020 nuk është lëjuar regjistrimi i studentëve të rinj në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” në t dy nivelet të studimeve: Bachelor dhe Master. Si rrjedhojë nuk është lejuar regjistrimi as në Fakultetin e Gjeoshkencave edhe pse të gjitha programet për të cilat është aplikuar janë të akredituara.

Kjo do të shkaktojë mjaft pasoja edhe për disa gjenerata sa i përket numrit të studentëve duke patur parasysh që viti i parë i studimeve paraqet bazamentin e disa gjeneratave të viteve vijuese të studimeve.

Studenët e diplomuar për vitin 2019

Gjatë vitit 2019 në Fakultetin e Gjeoshkencave ka vazhduar përfundimi i studimeve për nivelin Bachelor dhe Master. Numri i studentëve të diplomuar sipas niveleve të studimit dhe departamenteve është dhënë në tabelën 2.

Tabela 2. Numri i studentëve të diplomuar në Fakultetin e Gjeoshkencave në vitin 2019

Niveli i studimeve	Numri i studentëve të diplomuar			Gjithësejt
	Gjeologji	Xehetari	Materiale&Metalurgji	
Bachelor	11	21	2	34
Master	8	3	2	13
Gjithësejtë	19	24	4	47

Konkursi për staf akademik për vitin 2019

Gjatë vitit 2019 në Fakultetin e Gjeoshkencave bazuar në atë që u tha në lidhje me mosakreditimin institucional është shpallur konkurs vetëm për stafin akademik në rizgjedhje/avansim: një pozitë për lëndët Fizika eksperimentale I (O) (Metalurgji), Fizika eksperimentale II (O) (Metalurgji), Fizika e përgjithshme (O), Fizikë (O) (Gjeologji). Konkursi është shpallur më 15.11.2019 dhe procedurat do të përfundojnë në fillim të vitit 2020.

Aktivitetet shkencore e profesionale

Stafi i Fakultetit të Gjeoshkencave ka vazhduar me publikimin e punimeve shkencore nëpër revistat vendore e ndërkombëtare. Mbetet që në të ardhmën në Fakultetin e Gjeoshkencave të formojmë një procedure të mbledhjes së të dhënave të publikimeve e pjesëmarrjes në Konferenca e Kongrese shkencore me kohë në mënyrë që të formojmë bazën e të dhënave për stafin e FGJ.

Organizimi i Konferencës IMGCC 2019

Fakulteti i Gjeoshkencave, Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB) në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale në Tetor 2019 ka organizuar Konferencën e Parë Ndërkombëtare Multidisiplinare të Gjeoshkencave (IMGCC 2019).

Konferenca është mbajtur më 10 dhe 11 Tetor 2019 në Kampusin e Universitetit të Mitrovicës. Qëllimi kryesor i konferencës ishte të bashkojë akademikë, hulumtues, inxhinierë dhe profesionistë industrial për të paraqitur rezultatet e tyre kërkimore dhe aktivitetet e zhvillimit në fushën e gjeoshkencave.

Konferenca gjithashtu ka ofruar mundësi për kompanitë minerare për të prezantuar dhe promovuar metodologjitë, teknologjitë kërkimore bashkëkohore, shfrytëzimin e burimeve minerale, riciklimin dhe teknologjitë inovative të mbrojtjes së mjedisit. Pashtu ka patur edhe sesion të rezervuar për

studentët ku studentët e Universitetit të Mitrovicës janë paraqitur me punime të ndryshme nga fushëveprimtaria e fakulteteve në kuadër të UMIB në lidhje me gjeoshkencat dhe sektorin minerar. Fushat që ka mbuluar Konferenca kanë qenë: Gjeologjia, Minierat dhe Shfrytëzimi, Metalurgjia dhe Materiale, Resurset ujore, Ekonomia, Arsimimi dhe Legjislacioni.

Në Konferencë janë paraqitur 56 punime shkencore me rreth 150 pjesëmarrës nga rajoni dhe Evropa.

Në përgjithësi Konferenca është konsideruar shumë e suksesshme dhe Këshilli Organizativ dhe në mbështetje me Rektoratin ka vendosur që kjo konferencë të mbahet çdo vit. Pra, menjëherë do të fillojnë përgatitjet për mbajtjen e Konferencës IMGC 2020.

Bashkëpunimi në mes Fakulteteve, Institucioneve gjeoshkencore dhe Industrisë

Gjatë vitit 2019 Fakulteti i Gjeoshkencave ka realizuar edhe bashkëpunime me Fakultete dhe institucione shkencore nga lëmia e gjeoshkencave. Më poshtë po japim disa nga këto bashkëpunime:

- Në Shkurt të vitit 2019 një delegacion nga Fakultetimi i Gjeoshkencave i përbër nga Prof..Dr. Naser Peci, Dekan dhe Prof. Asoc. Dr. Muharrem Zabeli, Shef Departamentit Materiale&Metalurgji ka realizuar një vizitë në Universitetin e Lublanës - Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Inxhinierisë. Çështje që u diskutuan ishin mundësia e bashkëpunimit dhe avansimi i bashkëpunimit në mes të Fakulteteve tona, rrugët e mbështetjes së bashkëpunimit dhe pritshmëritë e bashkëpunimit. Gjatë kësaj janë vizituar Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Inxhinierisë dhe Instituti i Metaleve dhe Teknologjisë. Si rezultat i kësaj vizite dhe bashkëpunimit u nënshkruan edhe Marrëveshjet e Bashkëpunimit të mes të Univeritetit të Mitrovicës “Isa Boletini” – Fakulteti i Gjeoshkencave dhe këtyre dy institucioneve respective.

Të bashkangjitura këtij Raporti, Marrëveshjet e Bashkëpunimit

- Në Mars dhe Qershor të vitit 2019 në Fakultetin e Gjeoshkencave për studentët e Departamentit të Gjeoslogjisënë kuadër të Projektit **IncluESEE: Inclusion of the ESEE region and Ukraine in innovative exploration developments** (<https://eitrawmaterials.eu/project/incluesee/>) janë realizuar:

1. Trajnimi në lidhje me Metodologjitë e hulumtimeve gjeologjike Trajnimi ka përfshinë 4 ditë ligjerata dhe 2 (dy) ditë studim fushor . Ligjërata janë mbajtur nga Prof. Sabina Strmic-Palinkas – University of Tromso, Norvegji kurse studimi fushor ka përfshi rajonin Trepçës dhe Golesh – magnezite, organizuar nga kompania PROXIS nga Polonia.
2. Trajnimi në lidhje përdorimin e pajisjeve laboratorike. Trajnimi është mbajtur nga Ekspertët e Shërbimit Gjeologjik të Finlandës: Ferenc Molnar, Ph.D. – Research Professor; Jukka Kuva, PhD - Research Scientist; Marja Lehtonen, PhD - Team

- Manager; Hugh E. O'Brien, PhD - Senior Scientist. Studentët dhe stafi janë trajnuar mbi mënyrën e përdorimit mikroskopit, mikroskopit elektronik, identifikimin e përbërjes kimike dhe mineralogjike përmes ICP-MS, ICP-OES, ICP-MS LA. Të trajnuarit patën rastin për të parë përmes paraqitjes Remote Computer (përcjellja e procedurave të analizave laboratorike të realizuara në Shërbimin Gjeologjik të Finlandës drejtëpërdrejtë nga studentët e Universitetit të Mitrovicës).
- Në kuadër të bashkëpunimit në mes të Universitetit Mitrovicës “Isa Boletini – Fakulteti Gjeoshkencave dhe Universitetit Lublanës - Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Inxhinierisë në Tetor të vitit 2019 janë realizuar dy ligjërata njëditore nga:
Assist.prof.dr. Jože KORTNIK from University of Ljubljana, Faculty of Natural Sciences and Engineering, Department of Geotechnology, Mining and Environment dhe
Assist. prof. dr. Mitja PETRIČ from University of Ljubljana, Faculty of Natural Sciences and Engineering, Department of Materials and Metallurgy
 - Në kuadër të avansimit të bashkëpunimeve me industrinë janë zhvilluar takime me Menaxherin e Korporatës Energjetike të Kosovës, NewCoFeronikeli, SharrCem.

Furnizimi me pajisje laboratorike

Në vitin 2019 Fakulteti Gjeoshkencave ka vazhduar me furnizim me pajisje laboratorike në bazë të buxhetit të përcaktuar. Jemi furnizuar me:

- inventarë laboratorik për katër hapësira laboratorike në vlerë 74 000,0 €,
- pajisje laboratorike gjeologjike: Mikroskopa gjeologjik, Ulterazeri për matjen me ultrazë, për hulumtimin e qendrueshmerisë shkallën e prishjes dhe çarjet, Apartaura e Casagrandes – në vlerë 75000.0 €,
- pajisjeve hidrogjeologjike: Pajisje për matja e ujit të prrockave me prurje të vogël – në vlerë 15000, 0 €,
- pajisjeve metalurgjike: Furrë induktive për shkrirje, IN-SITU "Matja e Rezistencës Elektrike, Dilatometrisë dhe Analizës Termike, Analiza termike e njëkohshme (STA) – në vlerë 80 550,0 €.
- Softverë për lëminë e gjeoshkencave: Software ArcGIS 10.5, RockWorks – me vlerë 15450.0 €.

Gjithësejt për projekte kapitale për vitin 2019 në Fakultetin e Gjeoshkencave janë shpenzuar 260 000,0 €.

Krahas kësaj në kuadër të Marrëveshjes me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik nga Shërbimi Gjeologjik i Kosovës janë sjell në Fakultetin e Gjeoshkencave edhe pajisjet:

- ISPMS, Ftohësi, Mikrovala, Mulliri primar, Mulliri sekondar

Procesi mbarëvajtjes së mësimit

Procesi i mbarëvajtjes së mësimit në Fakultetin e Gjeoshkencave për vitin 2019 është realizuar sipas planit pa ndonjë vështirësi të caktuar. Realizimi i mësimit sipas muajve në Fakultetin e Gjeoshkencave është paraqitur në tabelën 3.

Tabela 3. Orët e realizuar të mësimit për vitin 2019 sipas muajve në FGJ

Muaji	Semestri	Nr i orëve mujore sipas angazhimit			Numri i orëve të mbajtura			Realizimi [%]	Shënim
		Ligjerata	Ushtirime	Gjithsejt	L	U	Gjithsej		
Janar	Dimeror 2018/2019	360	238	598	430	282	712	119.06	
Shkurt	Veror 2019/2020	288	190	478	83	38	121	25.31	
Mars		576	380	956	611	423	1034	108.16	
Prill		576	380	956	583	479	1062	111.09	
Maj		576	380	956	615	509	1124	117.57	
Tetor	Dimeror 2019/2020	452	352	804	474	362	836	103.98	
Nëntor		452	352	804	460	356	816	101.49	
Dhjetor		452	352	804	482	369	851	105.85	
Gjithesejt		3732	2624	6356	3738	2818	6556	103.15	

Procesi realizimit të provimeve

Në Fakultetin e Gjeoshkencave krahas afateve të rregullta të provimeve (afati Janar-Shkurt, Qershor dhe Shtator) me vendim të Senatit të UMIB janë organizuar edhe afatet e provimeve si vijon: afati i Prillit me së shumti dy provime, afati i Tetorit – për kusht me më së shumti dy provime dhe afatet për studentët e viteve të fundit - absolventë: afatet Mars, Maj dhe Nëntor.

Gjatë vitit 2019 janë mbajtur gjithësejt 1897 provime në dy nivelet e studimit, Bachelor dhe Master (tabela 4). Prej tyre 1618 provime janë mbajtur në nivelin Bachelor apo 85.29% dhe 279 provime janë mbajtur në nivelin Master apo 14.71%.

Tabela.4 Numri provimeve të mbajtura në FGJ

Afati provimeve	Niveli studimeve		Gjithesejt Bachelor+ Master
	Bachelor	Master	
	Te paraqitura	Te paraqitura	
Janar-Shkurt	404	65	469
Mars - Qershor	759	112	871
Shtator-Tetor-Nentor	455	102	557
Total 2019	1618	279	1897

Mbledhjet e Këshillit të Fakultetit

Në përputhje me Statutin e përkohshëm të UMIB gjatë vitit 2019 në Fakultetin e Gjeoshkencave janë mbajtur edhe mbledhjet e rregullta të Këshillit të Fakultetit. Mbledhjeve të Këshillit të Fakultetit u paraprijnë mbledhjet e Departamenteve dhe Komisionit të Studimeve në kuadër të Fakultetit. Në Fakultetin e Gjeoshkencave poashtu funksionon edhe Komisioni për pranimin e notave dhe ndërrimin e programeve. Gjatë vitit 2019 janë mbajtur gjithësejt 11 (njëmbëdhjetë) mbledhje të Këshillit të Fakultetit prej tyre 6 (gjashtë mbledhje Këshilli i vjetër kurse 5 (pesë) mbledhje Këshilli i ri i dalë pas zgjedhjeve në pranverë 2019. Në mbledhjet e Këshillit FGJ janë shqyrtuar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me funksionalizimin dhe mbarëvajtjen e Fakultetit të Gjeoshkencave në përputhje me Planin Strategjik të Fakultetit. Krahas çështjeve si janë kërkesat e studentëve, procedurat e diplomimit në nivelin Bachelor dhe Master, mbarëvajtja e mësimit, etj. në mbledhjet e Këshillit janë shqyrtuar edhe çështje që kanë të bëjnë me procesin e akreditimit, planprogramet mësimore, konkurset për rizgjedhje/avansim, vende të reja pune, angazhim të stafit dhe pika tjera të rëndësishme që janë paraqitur nga anëtarët e Këshillit.

Shtojca I
PLANET MËSIMORE
Fakulteti i Gjeoshkencave

Plani mësimor në vitin akademik 2019-2020

Departamenti Gjeologji

Bachelor: Programi Gjeologji

Viti II						
Semestri III						
201. Gj	O	Petrologjia magmatike dhe metamorfike	3	2+2	7	Prof. Dr. Islam Fejza Prfo Dr Ahmet Tmava
202. Gj	O	Gjeologji historike me paleontologji	3	2	6	Prof. Dr. Gani Maliqi Msc. Burbuqe Prekadini
203. Gj	O	Metodat instrumentale analitike	2	2	6	Prof. Dr. Flurije Sheremeti-Kabashi
204. Gj	O	Gjeodinamikë	2	2	6	Prof. Dr. Sylejman Hyseni
205. Gj	Z	Optika e mineraleve	2	2	5	Prof. Dr. Islam Fejza Ass Dr Festim Kutllovci
Pune ne lab/terren						Prof. Dr. Islam Fejza
Semestri IV						
209. Gj	O	Petrologjia Sedimentare	3	2+2	7	Prof. Dr. Islam Fejza, Ass Dr Festim Kutllovci
210. Gj	O	Bazat e Hidrogjeologjisë	3	2+1	7	Prof. Dr. Sabri Avdullahi
211. Gj	O	Gjeokimi	2	2	6	Prof. Dr. Flurije Sheremeti-Kabashi
212. Gj	O	Gjeologjia e Kuaternarit	2	2	5	Prof. Dr. Behxhet Shala
213. Gj	Z	Bazat e sedimentologjisë	2	2	5	Prof. Dr. Islam Fejza Ass Dr Festim Kutllovci
		Puna industriale		15 ditë		Prof. Dr Sylejman Hyseni Prof dr Bedri Durmishaj
Viti III						
Semestri V						
301 Gj.	O	Metodat gjeofizike ne gjeologji	3	2	7	Prof. Dr Afrim Koliqi
302 Gj.	O	Gjeologjia e vendburimeve	3	2+1	7	Prof. Dr Sylejman Hyseni
303 Gj.	O	Bazat e hidrogjeologjisë	3	2+1	7	Prof. Dr. Sabri Avdullahi
304 Gj.	O	Statistika dhe analiza e të dhënave në gjeologji	2	2	5	Prof. Dr. Naser Peci Prof Dr Flurije Sheremeti
305 Gj.	O	Gjeologjia mjedisore	2	2	5	Prof. Dr. Behxhet Shala
310 Gj.	Z	Bazat e minerografise	2	1	3	Prof dr Bedri Durmishaj
Semestri VI						
311 Gj.	O	Hartografim gjeologjik	3	2+1	7	Prof. Dr Afrim Koliqi
312 Gj.	O	Metodat e hulumtimeve të vendburimeve minerale	3	2	5	Prof. Dr. Ahmet Tmava
313. Gj	O	Gjeologjia e Kosovës	2	2	5	Prof. Dr. Zenun Elezaj
318. Gj	Z	Shpimet kërkimore	2	1	3	Prof. Dr. Gani Maliqi
		Punim i temës Bachelor			10	
		Gjithsej			30	

Master: Hidrogeologji me gjeologji inxhinierike

Viti II						
Semestri IX						
417. Iib	O	Metodologjia e punës kërkimore shkencore dhe hulumtuese	2	2	6	Prof. Dr. Ahmet Tmava
418. Iib	O	Kaptazhi I ujërave	2	2	6	Prof. Dr. Sabri Avdullahi
419. Iib	O	Gjeostatistika aplikative	2	2	6	Prof. Dr. Naser Peci
420. Iib	Z	Kapituj të zgjedhur nga shpimet e thella	2	2	6	Prof. Dr. Zenun Elezaj
424. Iib	Z	Mbrojtja e mjedisit	2	2	6	Prof. Dr. Behxhet Shala
Semestri X						
Punimi i temës Master					30	

DEPARTAMENTI I XEHETARISE

Viti i dyte

Lënda	K	O/Z	Ligjëratat	Ushtrimet	Fondi i orëve	
					Sem. I	Sem. II
Bazat e Gjeoteknikës	8	O	Dr.sc Rushit Haliti	Msc. Gëzim Ibishi	3+2	-
Detalet e Makinave	7	O	Dr.sc Ismet Ibishi	Msc Arber Zeqiraj	2+2	-
Softueri Aplikativ	5	O	Dr.sc Izet Zeqiri	Dr.sc Izet Zeqiri	2+2	-
Bazat e Gjeologjise	5	O	Dr.sc Gani Maliqi	Dr.sc Gani Maliqi	2+1	-
Kinematika me Dinamike	5	Z	Dr.sc Nazmi Hasi	Msc Arber Zeqiraj	2+1	-
Tek. Materialeve ne Min.	7	O	Dr.sc Muhamedin Het.	Msc. Gëzim Ibishi	-	3+1
Hulumtimi i VB Mineral	7	O	Msc. Festim Kutllovci	Msc. Festim Kutllovci	-	3+1
Bazat e Teknikes Minerare	7	O	Dr.sc Rafet Zeqiri	Dr.sc Rafet Zeqiri	-	3+1
Siguria ne Miniera	5	Z	Dr.sc Kemajl Zeqiri	Dr.sc. Kemajl Zeqiri	-	2+2
Teknika e komunikimit	4	Z	Dr.sc Nazmi Hasi	-		2+0

Viti i trete

Lënda	K	O/Z	Ligjëratat	Ushtrimet	Fondi i orëve	
					Sem. I	Sem. II
Hapja dhe përgatitja e VB	6	O	Dr.sc Muhamedin Hetemi	Msc. Gëzim Ibishi	3+2	-
Punimi i obj. minerare	6	O	Dr.sc Irfan Voca	Msc. Gëzim Ibishi	2+2	-
Teknika e shpim-plasjes	6	O	Dr.sc Rafet Zeqiri	Msc. Gëzim Ibishi	2+2	-
Mekanika e shkëmbinjve	6	O	Dr.sc Rafet Zeqiri	Msc. Gëzim Ibishi	2+2	-
PLM	4	Z	Dr.sc Bedri Durmishaj	Dr.sc Bedri Durmishaj	2+2	-
Mesim Praktik			Dr.sc Irfan Voca		2+0	
Tek. e eksploatimit nëntoksor	6	O	Dr.sc I. Voca	Msc. Gëzim Ibishi	-	3+2
Ajrimi dhe heq. e ujërave	6	O	Dr.sc Izet Zeqiri	Dr.sc Izet Zeqiri		3+2
Tek. e eksploatimit sip.	5	O	Dr.sc Kemajl Zeqiri	Msc. Gëzim Ibishi	-	3+2
Transporti ne Miniere	4	O	Dr.sc Irfan Voca	Dr.sc Irfan Voca	-	2+2
Mbrojtja e Mjedisit	3	Z	Dr.sc Kemajl Zeqiri	Dr.sc. Kemajl Zeqiri	-	2+1
Punimi Bachelor	8	O				

Master: Xehetari**Viti i dytë**

Lënda	K	O/Z	Ligjëratat	Ushtrimet	Fondi i orëve	
					Sem. IX	Sem. X
Specifikat dhe mënyrat e posaçme në shfrytëzimin nëntokësor	6	O	Dr.sc Sefedin Kastrati	Msc. Islam Ahmeti	2+2	-
Metodat e dimensionimit të shtyllave dhe pllakave siguruese	6	O	Dr.sc Rushit Haliti	Msc. Gzim Ibishi	2+2	-
Optimizimi në industrinë minerare	6	O	Konkurs	Msc. Gzim Ibishi	2+2	-
Vlerësimi gjeostatistik i rezervave	6	Z	Dr.sc Rafet Zeqiri	Dr.sc Rafet Zeqiri	2+2	-
Menaxhimi i minierave	6	Z	Dr,sc.Kemajl Zeqiri	Dr,sc.Kemajl Zeqiri	2+2	-
						-
Punimi seminari	10	O			-	
Tema e Masterit	20	O			-	

DEPARTAMENTI MATERIALE DHE METALURGJI**Bachelor**

Viti II						
Semestri III			Orë/Javë			
Kodi	O/Z	Lënda	L+T/P	U	ECTS	Mësimdhënësi (L/U)
201. M	O	Kimia fizike I	3	2	7	Prof. Ass. Dr. Nushe Lajçi/ Msc. Asis. Mimoza Kovaçi
202. M	O	Baza e shkences se materialeve I	3	1	6	Prof. Asoc. Dr. Mursel Rama
203. M	O	Bazat e teknologjisë së materialeve I	3	2	7	Prof. Asoc. Dr. Nurten Deva/ Msc. Asis. Bastri Zeka
204. M	O	Detalet e makinave	3	1	5	Prof.Asoc.Dr.Muharrem Zabeli/ Msc. Asis. Arbër Zeqiraj
205. M	Z	Termoinxhiniera në metalurgji	2	2	5	Prof.Asoc.Dr.Muharrem Zabeli/ Msc. Asis. Mimoza Kovaçi
Semestri IV						
207. M	O	Kimia fizike II	2	2	6	Prof. Ass. Dr. Nushe Lajçi/ Msc. Asis. Mimoza Kovaçi
208. M	O	Baza e shkences se materialeve II	3	2	7	Prof. Asoc. Dr. Mursel Rama/ Msc. Asis. Mimoza Kovaçi
209. N	O	Bazat e teknologjisë së materialeve II	3	2	6	Prof. Asoc. Dr. Nurten Deva/ Msc. Asis. Bastri Zeka
210. M	Z	Materialografia	2	2	6	Prof. Asoc. Dr. Mursel Rama/ Msc. Asis. Mimoza Kovaçi
212. M	Z	Elektroteknika	2	2	5	Prof. Ass.Dr. Nazmi Hasi Msc. Asis. Arbër Zeqiraj
Viti III (Specializimi: Metalurgji)						
Semestri V						
301.M.Ib	O	Pirometalurgjia I	2	2	6	Prof. Asoc. Zarife B. Gashi

302.M.Ib	O	Metalurgjia e metaleve me ngjyre	3	2	7	Prof. Asoc. Dr. Muharrem Zabeli/ Msc. Asis. Bastri Zeka
303.M.Ib	O	Elektro me Hidrometalurgji	3	2	6	Prof. Asoc. Ali Sadiku/ Msc. Asis. Arbër Zeqiraj
305.M.Ib	Z	Përpunimi i metaleve me ngjyre në gjendje të lëngët	2	2	4	Prof. Asoc. Zarife B. Gashi / Msc. Asis. Bastri Zeka
306.M.Ib	Z	Riciklimi i materialeve	2	2	4	Prof. Ass. Izet Ibrahimimi/ Msc. Asis. Bastri Zeka
307.M.Ib	Z	Sigurimi i cilësisë në metalurgji	2	2	4	Prof. Ass. Izet Ibrahimimi/ Msc. Asis. Arbër Zeqiraj
Semestri VI						
309.M.Ib	O	Pirometalurgjia II	2	2	4	Prof. Asoc. Zarife B. Gashi
310.M.Ib	O	Metalurgjia e hekurit dhe çelikut	3	2	6	Prof. Ass. Izet Ibrahimimi
312.M.Ib	Z	Teknologjia e prodhimit të ferronikelit	2	1	4	Prof. Asoc. Zarife B. Gashi/ Msc. Asis. Mimoza Kovaçi
313.M.Ib	Z	Teknologjia e prodhimit të zinkut	2	1	4	Prof. Asoc. Ali Sadiku/ Msc. Asis. Mimoza Kovaci
314M.Ib	Z	Përp i i Fe dhe çelikut në gj. të lëngët	2	1	4	Prof. Asoc. Dr. Muharrem Zabeli/ Msc. Asis. Bastri Zeka
	O	Praktika industriale	4	-	4	Prof. Asoc. Ali Sadiku
		Punimi Bachelor			10	

Master: Metalurgji

Viti II						
Semestri IX						
Kodi	O/Z	Lënda	L+T/P	U	ECTS	Mësimdhënësi (L/U)
418.M.IIb	O	Metodologjia e punës kërkimore	3	2	7	Prof. Asoc. Dr. Nurten Deva/ Msc. Asis. Bastri Zeka
419.M.IIb	O	Menaxhimi i projekteve	3	1	6	Prof. Asoc. Dr. Nurten Deva/ Prof. Ass. Izet Ibrahimimi
420.M.IIb	O	Riciklimi i materialeve	3	2	7	Prof. Asoc. Dr. Mursel Rama/ Msc. Asis. Arbër Zeqiraj
422.M.IIb	Z	Projektimi në metalurgji	2	2	5	Prof. Asoc. Dr. Muharrem Zabeli/ Msc. Asis. Bastri Zeka
423.M.IIb	Z	Metalet dhe civilizimet	2	1	5	Prof. Ass. Izet Ibrahimimi/ Msc. Asis. Mimoza Kovaci
Semestri X						
		Praktikë industriale	3		10	Prof. Asoc. Ali Sadiku
		Punimi i temës Master			20	

Shtojca II**Personeli mësimor i Fakultetit të Gjeoshkencave i angazhuar në procesin mësimor 2019-2020**

Në marrëdhënie të rregull pune			Bashkëpunëtorë		
Nr	Emri dhe Mbiemri	Thirrja	Nr	Emri dhe Mbiemri	Thirrja
1	Islam Fejza	Prof Dr	1	Sefedin Kastrati	Prof Dr
2	Sylejman Hyseni	Prof Dr	2	Nushe Lajçi	Prof Dr
3	Izet Zeqiri	Prof Dr	3	Ismet Ibishi	Prof Asoc Dr
4	Sabri Abdullahu	Prof Dr	4	Rushit Haliti	Prof Asoc Dr
5	Zenun Elezaj	Prof Dr	5	Muhamedin Hetemi	Prof Asoc Dr
6	Naser Peci	Prof Dr			
7	Gani Maliqi	Prof Dr			
8	Behxhet Shala	Prof Dr			
9	Bedri Durmishaj	Prof Dr			
10	Flurije Sheremeti	Prof Dr			
11	Afrim Koliqi	Prof Dr			
12	Ahmet Tmava	Prof Dr			
13	Irfan Voca	Prof Asoc Dr			
14	Mursel Rama	Prof Asoc Dr			
15	Ali Sadiku	Prof Asoc Dr			
16	Muharrem Zabeli	Prof Asoc Dr			
17	Rafet Zeqiri	Prof Asoc Dr			
18	Zarife Bajrakt. Gashi	Prof Ass Dr			
19	Nurten Deva	Prof Ass Dr			
20	Izet Ibrahimimi	Prof Ass Dr			
21	Nazmi Hasi	Prof Ass Dr			
22	Kemajl Zeqiri	Prof Ass Dr.			
23	Festim Kutllovci	Prof Ass Dr.			
24	Gzim Ibishi	Dr. Sc.Ass			
25	Arber Zeqiraj	Ass Msc			
26	Bastri Zeka	Ass MSc			
27	Mimoza Kovaçi	Ass MSc			

Shtojca III

Marreveshjet Bashkëpunimit

CO-OPERATION AGREEMENT

between

UNIVERSITY OF LJUBLJANA, Faculty of Natural Sciences and Engineering, SLOVENIA
and
UNIVERSITY OF MITROVICA (UoM), Faculty of Geosciences, Mitrovica, KOSOVO.

With a view to establishing collaboration between our institutions, of knowing each other better, for the benefit of the professional and scientific improvement of the students and teaching staff through a free exchange of information,

UNIVERSITY OF LJUBLJANA, Faculty of Natural Sciences and Engineering
and
UNIVERSITY OF MITROVICA (UoM), Faculty of Geosciences

will further and carrying out the following on a mutual basis:

1. Exchange of teaching staff, with the object of holding conferences and lectures, for documentation, information exchange of experience in the scientific and teaching fields.
2. Mutual participation into various scientific events (conferences, symposia and scientific meetings) whose programmes and themes will be sent to the other participants in due time.
3. Mutual exchange of scientific publications and textbooks as well as the mutual publishing of scientific papers.
4. The possibility of awarding scientific and honorific titles according to the international standards.
5. Participation together at the inter-university cooperation programmes of the Commission of the European Communities (for the example TEMPUS, ERASMUS+ and others).
6. Exchange of students and teaching staff groups for practical training periods.

The number of students and teaching staffs will be established with the agreement of both parties, annually.

The financial conditions for the progress of the cooperation activities carried out on the basis of the present agreement, will be ensured, if other financial sources are lacking, on a mutual basis.

The specific activities that meet the requirements of the collaboration will be developed collaboratively by both parties. They will also be subject to review every year during the four-year duration of this agreement.


UNIVERSITY OF MITROVICA (UoM)
Faculty of Geosciences

Dean
Prof. dr. Naser PEÇI



UNIVERSITY OF LJUBLJANA
Faculty of Natural Sciences and Engineering

Dean
Prof. dr. Boštjan MARKOLI



27-03-2019



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
ISABOLETINI
FAKULTETI I GJEOSHKENCAVE

Pranuar me datë 11.02.2019			
Njësia org.	Numri	Nr. sh.empl.	Vlera
	34		

AGREEMENT FOR COOPERATION
between
THE UNIVERSITY OF MITROVICA
and
INSTITUTE OF METALS AND TECHNOLOGY

for cooperation within the activities of the

The University of Mitrovica, Faculty of Geosciences, Department of Materials and Metallurgy, whose headquarters are in Mitrovica, Republic of Kosovo, represented by the Faculty of Geosciences, dean, Prof. Naser Peci and the Institute of Metals and Technology, whose headquarters are in Ljubljana, Republic of Slovenia, represented by director doc.dr. Matjaž Godec

Declare that

- in order to encourage the scientific projects, economic and to develop the field of Materials and Metallurgy, it is crucial to establish cooperation within the areas of science;
- in order to pursue their aims and proposals, they need to establish communicating channels to promote exchange activities;
- for these reasons both institutions consider very important the increasing of their relationships for academic and scientific cooperation and especially in scientific projects and in the framework of PhD study;
- the international cooperation has a high importance among the aims of both institutions.

For such purpose they have decided to sign scientific and cultural agreement by subscribing the following clauses:

Art. 1 – Aims of cooperation agreement

The University of Mitrovica, Faculty of Geosciences/Department of Materials and Metallurgy, and Institute of Metals and Technology will promote and to work in scientific projects with staff, profesors, scientists, researchers and students in the ambit of the agreement/ in

Art. 2 – Cooperation actions

The parties, to pursue the expressed aims in article 1, within their limits and in respect of their laws and regulations, commit themselves:

UNIVERSITETI I MITROVICËS



- promote institutional exchanges by inviting faculty and institute staff on the partner cooperation;
- institutions to participate in a variety of work and/or research activities and professional development;
- organize symposia, conferences, short courses and meetings on research issues;
- receive post graduate students of the partner institution for short term research exchange within the field of Materials and Metallurgy;
- carry out joint research;
- exchange information pertaining to developments in projects, student development and research at each institution;
- to development of collaborative research projects;
- to promote bilateral and multilateral research activities, projects and programs;
- to exchange research material;
- to cooperate in any other way it may seem useful and interesting;

Art.3 – Cooperation institution

Both parties shall collaborate on reciprocal basis to fulfill the models expressed in the present agreement. The Scientific cooperation shall be carried out by the staff, professors, researchers and students, according to the rules established by law in each country. The two Institutions, through their departments and coordinators, will make it possible for the professors, scientist, researchers and students to visit their laboratories and libraries and carry out the research work within the pre-agreed bilateral research projects.

Art. 4 – Financial support

Both Institutions shall be engaged in finding the internal and external funding sources, to support their activities, with each institution being responsible for its own expenses.

Art. 5 – Aim of the agreement

The present agreement represents a memorandum of understanding in order to enhance relationships for the reciprocal benefit of the parties and concerning scientific cooperation.

Art. 6 – Term

This Agreement shall become effective on the date that it is signed by both parties and shall be valid for a period of [5] years and can be renewed.

Art.7 – Validity

This agreement is drawn up in English. This version is to be considered valid.



Implementation

In order to carry out and fulfil the aims of this Agreement-Memorandum, the partner institutions shall each designate a Liaison Office and Coordinator who shall manage the development and conduct of joint activities:

At The University of Mitrovica
Faculty of Geosciences
Department of Materials & Metallurgy

Phd student. Bastri Zeka

At the Institute of Metals and Technology
The Head of Metallic Materials and
Technology department

prof. dr. Bojan Podgornik

In the spirit of international friendship and cooperation, we hereby set our signatures.

Signed on behalf of

Signed on behalf of

University of Mitrovica
Faculty of Geosciences
The Dean
prof.dr.Naser Peci

Institute of Metals and Technology

Director
doc.dr. Matjaž Godec

Signature

Date: 07.02.2019

Signature

Date: Lj. 6.2.2019

 Inštitut
za kovinske materiale
in tehnologije
Ljubljana 2

